



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Rexhë (Sali) Shoshit.
- II.**
1. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesa e parcelës nr. 10019-1, me sip. 334 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059- 10019-1, pjesa e parcelës nr. 1828-11, me sip. 622 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059- 01828-11, pjesa e parcelës nr. 1828-12, me sip. 742 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059- 01828-12, pjesa e parcelës nr. 1949-9, me sip. 1084 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059- 01949-9 dhe pjesa e parcelës nr. 7356-8, me sip. 116 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-7356-8, Zona Kadastrale Prishtinë, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues “Prishtina e Re, Zona Perëndim”, nr. 01. nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, dhe Planit rregullues “Muhaxhirët”, nr. 01, nr. 35-1299, dt. 29.06.2010.
 2. Kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është parcela nr. 00205, sip.1076 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00205-1, parcela nr. 00269-10, sip. 631 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00269-10, parcela nr. 00286-18, sip.1582 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00286-18, parcela nr. 00294-19, sip.1312 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00294 -19, parcela nr. 00295-23, sip.104 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00295-23, parcela nr. 00295-25, sip.805 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00295-25, Zona Kadastrale, Çagllavicë, në pronësi të Rexhë (Sali) Shoshit, me destinim rrugë, planifikuar sipas Planit rregullues, “Prishtina e Re - Zona Perëndim, nr. 01. nr. 35-186850, dt. 02.10.2013.
- III.** Këmbimi i pronës së paluajtshme të pronës komunale me pronën private të cekur në pikën II, është bërë për shkak se në pronën private është ndërtuar rruga e cila shfrytëzohet për interes publik, dhe kostoja financiare e shpronësimit është shumë e lartë, andaj për t’u shmangur pasojat e larta financiare që mund të vijën nga proceset gjyqësore, është propozuar që prona e lartcekur të këmbehet me pronën komunale.
- IV.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V.** Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.

duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.

- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Pronari i pronës private, sipas kërkesës nr. 06-464/01-94263/21, dt.26.05.2021 dhe nr. 13-463/03-106210/21, dt. 10.06.2021, ka kërkuar që të kompensohet për pronën private, e cila shfrytëzohet për interes publik, gjegjësisht për pronën e paluajtshme: Parcela nr. 00205, sip.1076 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00205-1, parcela nr. 00269-10, sip.631 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00269-10, parcela nr. 00286-18, sip.1582 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00286-18, parcela nr. 00294-19, sip.1312 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00294-19, parcela nr. 00295-23, sip.104 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00295-23, parcela nr. 00295-25, sip.805 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00295-25, Zona kadastrale Çagllavicë, në pronësi të Rexhë (Sali) Shoshit, me destinim rrugë, sipas Planit rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim” nr. 01. nr. 35-186850, dt. 02.10.2013.

Propozimi për inicimin e këmbimit të pronës komunale me pronën private të cekur në pikën II, është bërë për arsyet se në pronën private është ndërtuar rruga e cila shfrytëzohet për interes publik, dhe kostoja financiare e shpronësimit është shumë e lartë, andaj për tu shmangur pasojat e larta financiare që mund të vijën nga proceset gjyqësore, është propozuar që prona e lartcekur të këmbëhet me pronën komunale, gjegjësisht me pjesën e parcelës nr. 10019-1, me sip. 334 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059- 10019-1, pjesa e parcelës nr. 1828-11, me sip. 622 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059- 01828-11, pjesa e parcelës nr. 1828-12, me sip. 742 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059- 01828-12 dhe pjesa e parcelës nr. 1949-9, me sip. 1084 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059- 01949-9, pjesa e parcelës nr. 7356-8, me sip. 116 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059- 7356-8, Zona kadastrale, Prishtinë, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues, “Prishtina e Re - Zona Perëndim”, nr. 01. nr. 35-186850, dt. 02.10.2013 dhe Planit rregullues “Muhaxhirët”, nr. 01, nr. 35-1299, dt. 29.06.2010.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/03-112324/21, më 16.06.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

